



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 79, DATË 1.3.2023, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, "PËR AKREDITIMIN E VËZHguesVE AFATGJATË TË ORGANIZATËS QËNDRESA QYTETARE, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE", TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 1.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

**KËRKUES:** Organizatës "Qëndresa Qytetare" me seli në Tiranë,  
Rruga "Hoxha Tahsim", Pall. "Vjero" dhe përfaqësues z. Rigels Xhemollari;

**OBJEKTI:** Për një shtesë në vendimin nr. 79, të datës 1.3.2023, për akreditimin si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 64 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimi nr. 19, datë 27.1.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave"

Data: dd mm vvvv

Nr:  
Ora: hh:mm



"Për një shtesë në vendimin nr. 79, datë 1.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për akreditimin e vëzhguesve afatgjatë të organizatës Qëndresa Qytetare, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023".

## V Ë R E J:

Organizata Qëndresa Qytetare i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 5 (pesë) vëzhgues afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Organizata Qëndresa Qytetare është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Me vendimin nr. 79, datë 1.3.2023, të ndryshuar, janë akredituar 30 (tridhjetë) vëzhgues afatgjatë. Në kërkesën e paraqitur më datë 15.3.2023, kërkohet një shtesë për akreditimin e 5 (pesë) vëzhguesve afatgjatë.

Në zbatim të nenit 64 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pala që ka dorëzuar një kërkesë mund t’ a plotësojë ose ndryshojë atë, vetëm kur qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike si kërkesa fillestare.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 64 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 19, datë 27.1.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

## V E N D O S :

1. Akreditimin si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 të 5 (pesë) vëzhguesve afatgjatë të organizatës “Qëndresa Qytetare” sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Data: dd mm vvvv

Nr:  
Ora: hh:mm



“Për një shtesë në vendimin nr. 79, datë 1.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për akreditimin e vëzhguesve afatgjatë të organizatës Qëndresa Qytetare, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

2. Shtesa e miratuar do t'i shtohet listës nr. 1 të vëzhguesve afatgjate, të miratuar në vendimin nr. 79, datë 1.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të ndryshuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: dd mm vvvv

Nr:  
Ora: hh:mm



"Për një shtesë në vendimin nr. 79, datë 1.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për akreditimin e vëzhguesve afatgjatë të organizatës Qëndresa Qytetare, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023".